

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Kemi propozuar dy amendamente. Më lejoni t'i argumentoj shkurtimisht! Ato kanë të bëjnë me arsimin, edukimin. Duke ardhur nga bota akademike, në qoftë se flasim për arsimin si prioritet, pavarësisht se unë nuk e pashë as në programin e qeverisë, mendoj që do të duhet ta buxhetojmë arsimin. Fatkeqësisht, buxheti për arsimin është vetëm 3,51% i PBB-së, shumë larg në krahasim me rajonin, pavarësisht premtimeve të kësaj qeverie për ta rritur këtë buxhet në 5% të PBB-së. Amendamenti i parë i dedikohet arsimit parauniversitar, pra pagave të mësuesve. Për ne është i rëndësishëm investimi në burimet njerëzore për të rritur cilësinë e mësimdhënies në shkollat e fëmijëve tanë. Ne mendojmë se rritja me 6% e pagës së mësuesve të arsimit parauniversitar është e pamjaftueshme, duke marrë në konsideratë krizën ekonomike, rritjen e çmimeve të produkteve të shportës dhe të gjithë situatën ekonomike në të cilën ndodhet vendi, çka ka shtuar koston e jetesës, duke ndikuar edhe në koston e jetesës së mësuesve tanë. Ndaj në zërin e shpenzime korrente për arsimin bazë dhe arsimin e mesëm propozojmë të shtohen 2 miliardë lekë, respektivisht 1,4 miliardë lekë për arsimin bazë dhe 600 milionë lekë për arsimin e mesëm. Mendojmë që me rritjen e pagës së mësuesve dhe financimin e programeve të mësimdhënies, pa dyshim që në këtë mënyrë u japim dinjitet mësuesve tanë për punën e përkushtuar që bëjnë çdo ditë. Amendamenti i dytë i dedikohet arsimit të lartë. Pa dyshim që këtu ka dy prioritete, në këndvështrimin tonë. Së pari, rritja e pagave të pedagogëve, sepse ato nuk janë as në nivelin e rajonit, plus taksave që janë të detyruar të paguajnë, duke mos qenë në nivelin që ne kërkojmë për arsimin e lartë për t'u dhënë atyre dinjitet, prioritet dhe pa dyshim, llogaridhënie në cilësinë e mësimdhënies. Ne kemi parashikuar që në zërin shpenzime korrente për arsimin e lartë të shtohen 5 miliardë lekë. Nga ana tjetër, është kërkimi shkencor. Flasim për universitete, të cilat duhet të kthehen në institucione të mendimit kritik, të cilat duhet të jenë baza e ideve, e debateve, e kërkimit shkencor, e titujve akademikë dhe duhet të motivohen. Kjo gjë nuk mund të bëhet pa buxhet.

Prandaj, i gjithë vizioni ynë është për ta rritur buxhetin në zërin e kërkimit shkencor me 5 miliardë lekë, në mënyrë që universitetet tona të mos kenë thjesht titullin "qendra të kërkimit shkencor", por faktikisht të mbështeten nga buxheti i shtetit me buxhet të dedikuar për kërkimin shkencor, për fusha të ndryshme të cilat i duhen vendit. Kërkimi shkencor i orientuar në drejtim të nevojave që ka vendi sot në fusha të ndryshme do t'i shërbejë zhvillimit ekonomik e social të vendit. Unë besoj fort se, nëse duhet ta kemi prioritet kombëtar edukimin jo prioritet të një force apo të një force tjetër politike, ne do të duhet të ndërtojmë programe afatgjata, strategji afatgjata për arsimin që, kushdo që vjen në pushtet, do të duhet ta ndjekë atë vijë strategjike, sepse flasim për një prioritet kombëtar, siç është edukimi, dhe ai duhet t'i kalojë të gjitha interesat e vogla të partive politike.

Unë besoj fort që edukimi është arma më e fuqishme që kemi për të ndryshuar të ardhmen e vendit. Uroj që t'i shohim këto amendime me shumë devotshmëri dhe pozitivitet, si amendime në interes të publikut dhe, mbi të gjitha, në interes të një edukimi prioritar dhe në interes të shoqërisë të së ardhmes. Faleminderit!